



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 671/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Kimete Bardhi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Kimete Bardhi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, me shenjen ZL.Anr.671/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me nr. ZL.Anr.671/2017 me datën 09.11.2017 në ora 14:00, nga parashtruesja Kimete Bardhi, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik PDK, në të cilën pretendohet se në qendrën votimit 0315e/02D, është bërë bartja e votave nga numri rendor 12 tek kandidatët tjerë të të njëjtit subjekt politik. Kërkon nga PZAP-i që të rinumërohen votat dhe të ju kthehen votat e saj.

Parashtruesja e apeli si provë ka bashkangjitur një kopje të printuar të Formularit të Përputhjes së Rezultateve-FPR.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pretendimet e parashtruara në apel i vlerësoj si te pa bazuara dhe si te tilla i refuzoj për arsyes se gjate hetimit të bërë nga ekipi hetues i PZAP-it me date 11.11.2017 në kutinë e votimit:145636 në QNR, konstatoi se në vendvotimin 0315e/02D në QNR nuk ka pasur ndryshim të votave nga numri i votave të shpallura me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 2232-2017 të datës 08.11.2017 .

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara, sepse sipas hetimit të bërë nga PZAP, nuk qëndrojnë

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.671/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*